

Emri i Lëndës : Historia dhe Metodologjia e Tefsirit							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ISC 204	B	Pranverë	4.00	0.00	0.00	4.00	5.00
Lektori		Xhorxhina Seferi, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip, Anglisht, Turqisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Në këtë lëndë do të trajtohen: Studimi i formave të tefsirit që kanë lindur gjatë periudhave që ka kaluar tefsiri nga koha e Profetit (sas) deri në ditët e sotme. Kuptimet e fjalëve tefsir dhe te'u'il. Tefsiri dhe burimet e tefsirit në kohën e Profetit (sas). Tefsiri dhe burimet e tefsirit në kohën e sahabeve. Tefsiri në kohën e tabiinëve; tefsiri dhe israilijati; Lëvizjet e tefsirit pas periudhës së tabiineve. Tefsirët e parë dhe ndikimi i tyre. Studimi i autorëve që kanë shkruar në lidhje me zhvillimin e letërsisë paralelisht me këtë. Temat ku mbështetet metodologjia e tefsirit, shembujt në lidhje me rolin e tefsirit në drejtëkuptimin e Kur'anit.					
Objektivat		1. Vlerësimi i periudhave që ka kaluar shkenca e tefsirit duke filluar që nga koha e Profetit (s.a.s). 2. Trajtimi i temave të metodologjisë së tefsirit dhe prezantimi i disa veprave në këtë fushë. 3. Shqyrtimi me shembuj i rolit të tefsirit në drejtëkuptimin e Kur'anit.					
Konceptet Kryesore		1. Kur'an 2. Shpallje 3. Tefsir 4. Te'u'il 5. Metodë 6. Ekole 7. Muhkem					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Zbritja e Kuranit dhe regjistrimi i tij. Kjo temë trajton mënyrat dhe format e ardhjes së shpalljes hyjnore, gjendjet e Profetit (s.a.s) gjatë marrjes së vahjit, shkruajtësit e vahjit, etapat e zbritjes. Në këtë temë gjithashtu trajtohen edhe urtësitë e zbritjes së shpalljes hyjnore pjesë-pjesë, si u bë shkrimi i Kur'anit dhe shumimi i tij. Edit. Bahattin Dartma,Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq. 3-29.						
2	Shkenca e tefsirit, përkufizimi, objekti, synimi dhe konceptet bazike. Kjo temë do të trajtojë përkufizimet e disa termave bazikë siç janë: Tefsiti, te'vil, përkthim, meâl, mufessir, cila është tema, qëllimi dhe rëndësia e tyre. Po ashtu do të trajtohen edhe ndryshimet mes këtyre koncepteve. Edit. Bahattin Dartma,Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq.56-79.						
3	Historia e tefsirit: periudha e dy brezave të parë; Profetit (s.a.s) dhe sahabëve. Kjo temë fillimisht do të fokusohet në mënyrat e tefsirit gjatë periudhës së Profetit (s.a.s), me pas do të analizojë metodat e interpretimit të Kur'anit që përdorëshin nga sahabet. Gjithashtu do të përshkruhen edhe veçoritë e përgjithshme të tefsirit gjatë kësaj periudhe, burimet që u mbështetën sahabët gjatë interpretimit dhe do të përmenden edhe emrat e sahabëve më të shquar që janë marrë me tefsir. Edit. Bahattin Dartma,Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq. 81-94.						
4	Historia e tefsirit: periudha e dy brezave të dytë dhe në vijim; nga tabiunët, etbau't-tabiunët deri në ditët e sotme. Kjo temë do të trajtojë tefsirin në periudhën e tabiunëve, shkollat e tefsirit gjatë asaj periudhe dhe veçoritë e interpretimit të tabiunëve. Gjithashtu do të trajtohet tefsiri në periudhën e etbau't-tabiunëve deri në ditët e sotme, duke përmendur disa personalitete mjaft të rëndësishëm të shkencës së tefsirit që kanë dhënë kontribut të çmuar në shkrimin e veprave të tefsirit. Edit. Bahattin Dartma,Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq. 94-106.						
5	Llojet e tefsirit: Tradicional dhe interpretativ. Kjo temë do të analizojë dy llojet e tefsirit atë tradicional dhe interpretativ. Do të jepen përkufizimet për secilin lloj, do të tregohet zhvillimi i tyre historik dhe veçoritë e gjithësecilit. Gjithashtu do të përmenden disa nga interpretimet dhe interpretuesit më të njohur për secilin lloj. Edit. Bahattin Dartma,Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq. 108-131						

6	Ekolet e tefsirit. Në këtë temë do të trajtohen ekolet klasike dhe moderne të tefsirit. Do të jepen përkufizimet e tyre, llojet e tefsirit për secilin nga ekolet, arsyet që çuan në lindjen e secilit lloj bashkë me karakteristikat e tyre dhe disa vepra që janë shkruar për secilin lloj tefsiri. Edit. Bahattin Dartma, Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq.133-155.
7	Klasifikimi i shkencave të Kuranit. Në këtë temë do të shpjegohet në mënyrë specifike klasifikimi i shkencave të Kur'anit dhe nën ndarjet e secilës shkencë. Edit. Bahattin Dartma, Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq. 157-230.
8	Provimi Gjysmë-final
9	Shkencat historike: Shkaqet e zbritjes dhe historitë në Kuran. Në këtë temë trajtohen shkaqet e zbritjes të ajeteve, llojet e shkaqeve të zbritjes dhe dobët e mësimi të këtyre shkaqeve. Gjithashtu do të trajtohen llojet e historive në Kur'an, veçoritë dhe qëllimet e tyre. Edit. Bahattin Dartma, Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq.211-217; 220-227.
10	Shkencat historike: Shfuqizimi i ajeteve dhe israilijat. Në këtë temë trajtohen argumentet e shfuqizimit, llojet e tij. Gjithashtu trajtohen mënyra se si israilijati ka hyrë në tefsir dhe llojet e lajmeve të israilijatit. Edit. Bahattin Dartma, Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq.217-220; 227-232.
11	Shkencat gjuhësore: Fjalët e huaja në Kuran, mubhematu'l-Kur'an dhe muxhmel-mubejen Në këtë temë trajtohen fjalët e huaja të ilustruara me shembuj nga Kur'ani. Gjithashtu trajtohen arsyet e mubhemit në Kur'an, temat në të cilat ka shpjegime pa detaje (muxhmel) dhe shpjegime të detajuara (mubejen). Edit. Bahattin Dartma, Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq. 164-170.
12	Shkencat gjuhësore: Shprehja figurative, shembujt dhe betimet në Kuran. Në këtë temë do të trajtohen llojet e shkencave gjuhësore, pjesë e të cilave janë edhe shprehjet figurative. Do të trajtohen llojet e shprehjeve figurative të përdorura në Kur'an të ilustruara me shembuj dhe betimet në Kur'an. Edit. Bahattin Dartma, Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq.158-162;178-183.
13	Shkencat kuptimore: Muhkem-muteshabih dhe shkronjat e ndërprera. Në këtë temë trajtohen ajetet nga ana kuptimore. Arsyet e ekzistencës së dy llojeve dhe nën ndarjet e secilit të ilustruar me shembuj nga Kur'ani. Edit. Bahattin Dartma, Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq.162-167;180-191.
14	Shkencat kuptimore: Mushkilu'l-Kuran dhe ixhazu'l-Kuran. Në këtë temë do të shpjegohet çfarë është mushkilu'l-Kur'an, arsyet e lindjes së saj ndërmjet ajeteve Kur'anore. Gjithashtu do të trajtohet ixhazu'l-Kur'an dhe dimensionet e mrekullisë. Shkencat kuptimore: Mushkilu'l-Kuran dhe ixhazu'l-Kuran. Në këtë temë do të shpjegohet çfarë është mushkilu'l-Kur'an, arsyet e lindjes së saj ndërmjet ajeteve Kur'anore. Gjithashtu do të trajtohet ixhazu'l-Kur'an dhe dimensionet e mrekullisë. Edit. Bahattin Dartma, Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq.192-194; 198-203
15	Shkencat kuptimore: Relatat ndërmjet ajeteve dhe sureve, stili i shprehjes dhe gramatika në Kuran. Në këtë temë trajtohen llojet e relatave midis ajeteve dhe sureve, mënyra e stilit të shprehjes së Kur'anit dhe informacione në vija të përgjithshme në lidhje me gramatikën e Kur'anit. Edit. Bahattin Dartma, Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013, fq.195-198; 203-209.
16	Provimi Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Edit. Bahattin Dartma, Tefsir Tarihi ve Usulü, Eskişehir: 2013,	
Referenca të tjera	
• M. Akgül, Kur'ân İklimine Seyahat, Işık Yayınları, İstanbul: 2008. • Ömer Çelik, "Tefsir Usulü ve Tarihi", Erkam Yayınları, İstanbul: 2012. • Rushit Musallari, Ajka e Shkencave Kuranore, Tiranë 2018.	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studenti do të mësojë periudhat në të cilat ka kaluar shkenca e tefsirit duke filluar që nga koha e Profetit (s.a.s).
2	Studenti do të përfotjë njohuri rreth temave të metodologjisë së tefsirit dhe rreth disa veprave në këtë fushë.
3	Studenti do ketë mundësi të japë shembuj në lidhje me rolin e tefsirit në drejtëkuptimin e Kur'anit.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	1	15	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			55
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			45
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	3	3
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00